

AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DM CONSULENZA” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- Z. Emidio Di Mattia, shtetas Italian, I datelindjes 02.01.1970, lindur ne Teramo Itali dhe banues ne Tortoreto (TE) Via U. Foscolo 14 i.2 , madhor me me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I kartes se identitetit me Nr. AU8541724.

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901,datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 28/10/2022 hartoj në këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**DM CONSULENZA SH.P.K**”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “**DM CONSULENZA SH.P.K**”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **DM CONSULENZA SH.P.K**”, do të ketë zyrën e saj qëndrore ne: Xhafzotaj, Autostrada Durres-Tirane, prane mbikalimit te Fllakes Z.K 2574, Nr.Pasurie 159/79. Durres.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti I veprimtarisë

Shoqëria ka siobjektaktivitetinëShqipëridhejashtë:

Konsulence ne fushen teknike te prodhimit te produkteve bimor dhe shtazor dhe te marketingut per shoqeri dhe shtete pjestar te bashkimit europian dhe me gjere. Shoqeria mund te kryeje konsulenca ne fushen e legjislacionit te aplikuar, ne fushen tregtare dhe te berit biznes si dhe ne fushat e industrise , turizmit dhe energjise apo ne sherbime pune te specializuara, konsulenca ne aktivitete qe synojne

zhvillimin midis vendeve ne fushen e mekanikes aplikuar, Moulds, trup sherbimi, Led-sisteme ndricimi, produkte alkoolike, sherbime brokeri apo dhenie me qera dhe anije, linjat civile transportit rrugor, operacione qe lidhen me pasurite e paluajtshme , operacione financiare dhe kredimarrje, tu jap garanci te treteve si dhe te bleje dhe shese ose marre me qera ndermarrje , degë ndermarrjesh si dhe te kete pjesmarrje ne shoqeri , ente, konsorciume, te themeluara apo ne themelim e siper qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise.

Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te shoqerise.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me date 31/Dhjetor/2050 dhe mund të shtyhet sipas ligjeve në fuqi.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "DM CONSULENZA" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin shoqërisë "DM CONSULENZA" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "DM CONSULENZA" SHPK është 1.000 (njemije) Leke, ndarë në 1 kuotë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. Emidio Di Mattia është ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. EMIDIO DI MATTIA.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Emidio Di Mattia



28.10.2022